

## KONTRATË DHURIMI TE PJESEVE TE KAPITALIT

(“Kontrata”)

Lidhur sot në datë 21.08.2020, ndërmjet

Valbona Bamllari, e bija e Petritit dhe e Dritës, lindur më 10.09.1967, në Korçë, banuese në adresën: Rruga: “Ismail Qemali”, Pallati 7, Hyrja 2, Apartamenti 13, Tiranë shtetase shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin nr. G75910048I;

Më poshtë “Dhuruesi”

DHE

Enea Bamllari, i biri i Rolandi dhe i Valbonës, lindur më 02.06.1991, në Korçë, banues në adresën: Rruga: “Ismail Qemali”, Pallati 7, Hyrja 2, Apartamenti 13, Tiranë shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin nr. J10602063M;

Olger Bamllari, i biri i Rolandi dhe i Valbonës, lindur më 15.04.1995, në Korçë, banues në adresën: Rruga: “Ismail Qemali”, Pallati 7, Hyrja 2, Apartamenti 13, Tiranë shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin nr. J50415043P;

Më poshtë “Pranuesit e Dhurimit”

Që më poshtë do të luhen Pala ose/dhe Palët

Të cilët ranë dakort të lidhin këtë kontratë me kushtet dhe afatet e mëposhtme:

### **DUKE PATUR PARASYSH QË:**

- (A) Dhuruesi, Valbona Bamllari është zotëruese e 1 kuote (pjesë), e cila përfaqëson 33.33% të pjesëmarrjes në përqindje (%) në kapitalin e shoqërisë, me vlerë 28.000.000,00 lekë në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “ERA 2000” shpk, me NIPT/NUIS K11627002V, regjistruar në datën 20/09/1999, me kapital të shoqërisë 84.000.000,00 Lekë;
- (B) Dhuruesja dëshiron të dhurojë pjesën e saj në kapitalin e shoqërisë, në mënyrë të barabartë tek Pranuesit e Dhurimit;
- (C) Pranuesit e Dhurimit pranojnë dhurimin e pjesës së Dhurueses në mënyrë të barabartë dhe kalimin e kuotës dhe pjesëmarrjes së Dhurueses në shoqëri.

- (D) Në përputhje me Nenin 7 të Statutit të Shoqërisë, ortaku i shoqërisë i cili zotëron 2/3 e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë ka dhënë në datën 20.08.2020 miratimin e tij me shkrim për kalimin e 1 kuote, që përfqëson 33.33% të pjesëmarrjes në përqindje (%) në kapitalin e shoqërisë, me vlerë 28.000.000,00 lekë tek Pranuesit e Dhurimit

**PALET BIEN DAKORD** sa më poshtë vijon:

## **NENI 1 INTERPRETIM**

- (a) Deklarimet dhe listimet e kësaj Kontrate, janë pjesë themelore të saj, duke i detyruar Palët ekzistuese, pasardhësit, pritësit dhe të caktuarit.

- (b) Termat e mëposhtëm të kësaj kontrate kanë këto kuptime:

“Ligji Tregtar i Shoqërisë” nënkupton Ligji i Republikës së Shqipërisë Nr. 9901, datë “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

“Regjistri Tregtar i Shoqërive” nënkupton regjistrin e mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ku pasqyrohen të gjitha shoqëritë tregtare si dhe çdo ndryshim tjetër pauses në statusin e tyre.

“Kuota” nënkupton shumën totale të kuotës që përfaqëson 33.33% të kapitalit të shlyer të Shoqërisë ERA 2000 shpk, për t’u transferuar nga Dhuruesi tek Pranuesit e Dhurimit.

- (c) Titujt e kësaj Kontrate nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

## **NENI 2 OBJEKTI I KONTRATES**

- 2.1 Bazuar në këtë kontratë Dhuruesi bie dakord t’i dhurojë Pranuesve të Dhurimit dhe këta të fundit pranojnë Dhurimin e Dhuruesit të **1 kuote (pjesë), e cila përfaqëson 33.33% të pjesëmarrjes në përqindje (%) në kapitalin e shoqërisë, me vlerë 28.000.000,00 lekë në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar ERA 2000 shpk.**
- 2.2 Dhuruesi i dhuron Pranuesit të Dhurimit Enea Bamllari 50% (pesëdhjetë përqind) të pjesëmarrjes së saj në shoqëri e cila përfaqëson 16.665% të pjesëmarrjes në përqindje (%) në kapitalin e shoqërisë, me vlerë 14.000.000, 00 Lekë.
- 2.3 Dhuruesi i dhuron Pranuesit të Dhurimit Olger Bamllari 50% (pesëdhjetë përqind) të pjesëmarrjes së saj në shoqëri e cila përfaqëson 16.665% të pjesëmarrjes në përqindje (%) në kapitalin e shoqërisë, me vlerë 14.000.000, 00 Lekë.

- 2.4 Pas nënshkrimit dhe regjistrimit të kësaj Kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Dhuruesja Valbona Bamllari nuk do të zotërojë asnjë pjesë të kapitalit në Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar ERA 2000 shpk.
- 2.5 Pas këtij transaksioni përbërja e kuotave dhe kapitalit të Shoqërisë ERA 2000 SHPK bëhet si më poshtë:
- Enkel Bamllari zotëron 1 kuotë (pjesë) që përfaqëson 66,67 (gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e shtatë përqind) të pjesëmarrjes në përqindje (%) në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë 56.000.000,00 Lekë.
  - Enea Bamllari zotëron 1 kuotë (pjesë) që përfaqëson 16.665% (gjashtëmbëdhjetë presje gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë përqind) të pjesëmarrjes në përqindje (%) në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë 14.000.000, 00 Lekë.
  - Olger Bamllari, zotëron 1 kuotë (pjesë) që përfaqëson 16.665% (gjashtëmbëdhjetë presje gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë përqind) të pjesëmarrjes në përqindje (%) në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë 14.000.000, 00 Lekë.

### **NENI 3 GARANCITË, TE DREJTAT DHE DETYRIMET**

#### **3.1 Detyrimet dhe të drejtat e Dhuruesit**

Dhuruesi përfaqëson dhe garanton sa më poshtë:

- (a) Ka autoritetin dhe kapacitetin ligjor për të lidhur këtë Kontratë dhe të përfundojë transaksionet të parashikuara në këtë kontratë;
- (b) Pas përfundimit të dhurimit nuk do të zotërojë asnjë pjesë të kapitalit të shoqërisë ERA 2000 SHPK;
- (c) Ka marrë pëlqimin e nevojshëm sipas Nenit 7 të Statutit të Shoqërisë nga ortaku i shoqërisë i cili zotëron 2/3 e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë ka dhënë në datën 19.08.2020
- (d) Dhuruesi garanton Pranuesit e Dhurimit se pjesët e saj të kapitalit janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barre dhe mbi të nuk ekziston asnjë detyrim ligjor nga persona të tretë.
- (e) Kjo kontratë përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjor të Dhuruesit.
- (f) Dhuruesi deklaron dhe garanton Pranuesit e Dhurimit se: (i) Dhuruesi ka të drejte të lidhe këtë Kontratë e të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin prej saj; (ii) Dhuruesi nuk është pale në ndonjë konflikt gjyqësor apo

administrativ ne proces dhe/ose nuk kërcënohet nga fillimi i ndonjë procedure gjyqësore apo administrative kundër saj qe mund te cenoje pjesët e saj të kapitalit; (iii) kjo Kontrate përbën detyrim ligjor, te vlefshëm dhe te ekzekutueshëm për Dhuruesin dhe trashëgimtarët e tij;

- (g) Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Dhuruesi humbet çdo të drejtë mbi kuotën e saj dhe pjesën e saj të kapitalit në shoqëri, te drejte te cilën e fitojnë Pranuesit e Dhurimit pas regjistrimit në qendrën Kombëtare të Biznesit.

### **3.2 Detyrimet dhe të drejtat e Pranuesve të Dhurimit**

- (a) Pranuesit e Dhurimit pranojnë dhurimin me vullnetin e tyre të lirë të lirë dhe të plotë;
- (b) Pranuesit e Dhurimit nuk kanë asnjë ndalim ligjor të pranojnë Dhurimin.
- (c) Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, Pranuesit e Dhurimit bëhen zotërues të pjesëve të kapitalit në shoqëri sipas përcaktimit të Nenit 2 të kësaj Kontrate.

## **Neni 4 TË NDRYSHME**

### **4.1 Ndryshimet dhe Heqja dorë**

Çdo ndryshim, apo heqje dorë nga secila nga Palët në këtë kontratë është e vlefshme vetëm kur është me shkrim dhe e nënshkruar nga Palët.

Transferimi i Kuotave të Shitjes ka efekt të menjëhershëm pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

### **4.2 Njoftimet**

Çdo njoftim, kërkesë ose çdo letër tjetër që do të jepet sipas kësaj Kontratë, duhet të paraqitet me shkrim. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, ky njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër do të konsiderohet si i dhënë rregullisht kur është dhënë dorazi, me postë, teleks ose faksimile Palës përkatëse në adresën e saj siç do të jepet herë pas here.

#### 4.3 Ligji i zbatueshëm

Kjo Kontratë rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

#### 4.4 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, kontradiktë, apo pretendim që ka të bëjë me këtë Kontratë, ose çdo shkelje e kushteve apo afateve të saj duhet të zgjidhet miqësisht; në të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### 4.5 Zbatimi i Kontratës

Në rast se një nga dispozitat e kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme apo e pazbatueshme në ndonjë juridiksion, ajo nuk duhet të ndikojë:

- (a) Në vlefshmërinë apo zbatueshmërinë në juridiksionin e çdo dispozite të kësaj Kontrate; ose
- (b) vlefshmërinë apo zbatueshmërinë në juridiksione të tjera të saj ose çdo dispozite tjetër të kësaj Kontrate.

### NENI 5

#### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- 5.1 Kontrata aktuale përbën marrëveshjen e palëve në lidhje me këtë çështje si dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme me shkrim apo me gojë nga palët.
- 5.2 Kjo kontratë është firmosur në 4 (katër) kopje origjinal në Shqip, secila me të njëjtën vlerë ligjore.

#### Për Dhuruesin

**Valbona BAMLLARI**

Valbona Bamllari



#### Për PRANUESIT E DHURIMIT

**Enea Bamllari**

Enea Bamllari

**Olger Bamllari**

Olger Bamllari

